

## RAPORT I NDËRMJETËM 6–22 Prill 2023

28 Prill 2023

### I. PËRMBLEDHJE

- Në zgjedhjet vendore të 14 majit, zgjedhësit do të zgjedhin kryetarët e bashkive dhe këshilltarët për 61 bashkitë e Shqipërisë. Mjedisi politik vazhdon të jetë i karakterizuar nga polarizimi i thellë ndërmjet kryetarëve të partive të mëdha.
- Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor u ndryshuan për herë të fundit në 2020, dhe dispozitat e reja ligjore, ndër të tjera, që lidhen me administrimin zgjedhor, financimin e fushatës dhe masat mbrojtëse kundër abuzimit me burimet publike, do të zbatohen për herë të parë në zgjedhjet vendore. Këto dispozita adresuan një sërë rekomandimesh të mëparshme të ODIHR-it, por mbeten ende për t'u zbatuar shumë rekomandime prioritare.
- Pas ndryshimeve të vitit 2020, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) përbëhet nga tre organe të veçanta drejtuese: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) dhe Nënkomisioneri, Komisioni Rregullator, dhe Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS). Përgatitjet zgjedhore po zhvillohen me një fushatë të gjerë dhe shumë të dukshme për edukimin e votuesve, duke përfshirë dhe gjuhët e pakicave kombëtare. Deri tani, administrata zgjedhore ka respektuar shumicën e afateve ligjore. Shumica e bashkëbiseduesve të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) vunë re transparencë dhe hapje të shtuar në vendimmarrjen e KQZ-së. Në tre bashki, KQZ do të zhvillojë një projekt pilot të votimit elektronik.
- Për këto zgjedhje janë regjistruar rreth 3,65 milion zgjedhës. Zgjedhësit mund të verifikojnë të dhënat e tyre dhe të kërkojnë korrigjime, edhe nëpërmjet internetit, gjatë periudhës së shqyrtimit publik. Identifikimi i zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve kryhet duke përdorur pajisje elektronike identifikimi. Disa bashkëbisedues të MVZ-së të ODIHR-it kanë deklaruar se ndryshimi i fundit i qëndrave të votimit mund të çorientojë zgjedhësit në ditën e zgjedhjeve.
- Gjithsej 40 parti dhe koalicione me 144 kandidatë për kryetarë bashkie dhe rreth 23,700 kandidatë për këshilltarë garojnë në këto zgjedhje. Të gjitha listat e këshillave i përmbushin kriteret për gjininë të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.
- Periudha 30 ditore e fushatës filloi më 14 prill dhe është veçanërisht e dukshme në Tiranë. Deri më tani, fushata nuk ka qenë e bujshme, dhe përgjithësisht ka patur një ton të moderuar. MVZ-ja e ODIHR-it është në dijeni të dy rasteve të dhunës, në njërin prej të cilave u rrezikua jeta e një anëtarit partie. Ndryshimet e fundit paraqitën masa të tjera mbrojtëse kundër abuzimit me burimet shtetërore. Megjithatë, shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësime lidhur me iniciativat e fundit të ndërmarra nga qeveria, siç është bonusi i pensionistëve dhe premtimet e kryeministrit lidhur me pagat e punonjësve të sektorit publik. Komisioneri deklaroi publikisht se sipas interpretimit të tij, dispozitat ligjore përkatëse zbatohen vetëm për zgjedhjet parlamentare.
- 13 nga 17 ministrat e qeverisë dhe 50 nga 140 anëtarët e parlamentit (35 përqind) janë femra. Kodi Zgjedhor parashikon një kuotë gjinore prej 50-përqind për listat e këshillave bashkiakë, me kritete të përcaktuara qartë. Janë vetëm 15 femra midis 144 kandidatëve për kryetarë bashkie. Tre

nga 12 anëtarët e KQZ-së, përfshirë Nënkomisioneren, janë femra, ashtu si dhe 29-përqind të anëtarëve të nivelit të mesëm të komisionit zgjedhor.

- Garuesit mund të financojnë fushatën e tyre me fonde publike dhe private. Ligji parashikon kufizime për dhurimet dhe shpenzimet e fushatës. Garuesve nuk iu kërkohet të deklarojnë publikisht përpara ditës së zgjedhjeve, burimin dhe sasinë e fondeve të mbledhura por duhet të dorëzojnë raporte financiare pas ditës së zgjedhjeve. Kodi Zgjedhor parashikon një listë të hollësishme të sanksioneve për shkeljet financiare të fushatës. Garuesit u qartësuan lidhur me kufizimet për shpenzimet e fushatës vetëm një javë para se të fillonte fushata, atëherë kur KQZ-ja vendosi shpërndarjen e fondeve publike shtesë për fushatën, e cila përdoret për të përllogaritur kufirin e shpenzimeve.
- Mjedisi mediatik është i shumëllojshëm, me operatorë të shumtë që veprojnë në një treg të kufizuar reklamash. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësimet se përqëndrimi dhe kontrolli i mediave nga ndërthurja e interesave të biznesit dhe interesave politike, krijojnë pengesa për pavarësinë editoriale dhe i bëjnë gazetarët të pambrojtur ndaj presionit dhe vetë-censurimit. Shpifja vazhdon të jetë vepër penale dhe është e dënueshme me gjoba të rënda. Sipas ligjit, mediat transmetuese duhet të paraqesin një mbulim të paanshëm dhe të balancuar të fushatës, dhe janë vendosur masa për transparencën e reklamimit të zgjedhjeve dhe raporteve për monitorimin e mediave. Ligji parashikon kohë pa pagesë në transmetuesin publik dhe kohë të paguar në mediat e transmetimit privat. Autoriteti i Mediave Audiovizive ka për detyrë të monitorojë transmetuesit për përmbushjen e kriterëve ligjore për mbulimin e fushatës.
- Ankimet mund të depozitohen nga garuesit, interesat ligjorë të së cilëve janë prekur. Zgjedhësit mund të depozitojnë ankime lidhur me përfshirjen e tyre në listën e zgjedhësve, dhe vëzhguesit mund të apelojnë vetëm refuzimin e akreditimit të tyre. Procedura e ankimit administrativ është e hollësishme dhe përfshin garanci të procesit të rregullt ligjor. Deri më 22 prill, 23 ankesa janë paraqitur në KAS, shumica në lidhje me regjistrimin e kandidatëve. KAS-i gjithashtu shqyrtoi 20 kërkesa të Komisionerit për vendosjen e sanksioneve për abuzim me burimet publike dhe pranoi 10 prej tyre. Kolegji Zgjedhor deri më tani ka gjykuar 11 ankime.
- Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgim qytetar dhe ndërkombëtar të të gjitha fazave të procesit zgjedhor. Përfaqësues të partive, koalicioneve dhe kandidatëve të pavarur munden gjithashtu të vëzhgojnë. Deri më 22 prill, KQZ-ja ka regjistruar rreth 180 vëzhgues vendorë dhe 131 vëzhgues ndërkombëtarë.

## II. HYRJE

Me ftesë për të vëzhguar zgjedhjet vendore të 14 majit dhe bazuar në rekomandimin e Misionit të Vlerësimit të Nevojave të zhvilluar nga data 8 deri më 11 nëntor 2022, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) ngriti Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) më 6 prill<sup>1</sup>. Misioni, i kryesuar nga Ambasadorja Audrey Glover, përbëhet nga një ekip bërthamë prej 13 vetësh i vendosur në Tiranë dhe 24 vëzhgues afatgjatë të dërguar më 13 prill në 12 qarqet në mbarë vendin. Anëtarët e misionit vijnë nga 21 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. ODIHR-i u ka kërkuar Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së të dërgojnë 300 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar procedurat në ditën e zgjedhjeve.

<sup>1</sup> Shiko [Raportet e mëparshme të ODIHR-it mbi Shqipërinë](#).

### III. SITUATA DHE KONTEKSTI POLITIK

Shqipëria është një Republikë parlamentare, me kompetenca legjislativë të një parlamenti një-dhomësh. Qeveria, e udhëhequr nga kryeministri, ushtron kompetenca të gjera ekzekutive. Më 24 tetor 2022, në përputhje me Kushtetutën, Presidenti Bajram Begaj thirri zgjedhjet vendore më 14 maj 2023.

Zgjedhjet e fundit vendore u zhvilluan në 2019. Opozita Partia Demokratike (PD), Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI; që është riemëruar Partia e Lirisë, e udhëhequr nga ish-presidenti Ilir Meta), dhe disa parti më të vogla i bojkotuan ato zgjedhje, në të cilat një koalicion i udhëhequr nga qeverisësja Partia Socialiste (PS), fitoi 60 nga 61 bashkitë<sup>2</sup>. Kandidati i Partisë së Minoritetit Etnik Grek (MEGA) u zgjodh kryebashkiak i bashkisë së Finiqit (Qarku Vlorë)<sup>3</sup>.

PS fitoi gjithashtu zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 me 74 nga 140 vendet në parlament<sup>4</sup>. Kështu, Edi Rama, në krye të qeverisë, mbajti postin e tij për një mandat të tretë që nga viti 2013.<sup>5</sup> Mjedisi politik vazhdon të jetë i karakterizuar nga dominimi i elitave politike tradicionale dhe nga polarizimi i thellë ndërmjet partive të mëdha. Kjo, e shoqëruar nga një konflikt brenda PD-së, ndikoi në punën e parlamentit, duke përfshirë dhe reformën zgjedhore.

Pas zgjedhjeve të vitit 2021 dhe shpalljes *persona non grata* nga qeveria e SHBA-së e ish-presidentit, ish-kryeministrit dhe kryetarit të PD-së për një kohë të gjatë, Z. Sali Berisha, kryetari i atëhershëm i PD-së, Lulzim Basha, e përjashtoi atë nga grupi parlamentar i PD-së.<sup>6</sup> Pas humbjes së PD-së në zgjedhjet e parakohshme për kryetar bashkie të marsit 2022, z. Basha dha dorëheqjen si kryetar partie dhe Enkelejd Alibeaj, kreu i grupit parlamentar të PD-së, u bë ushtrues i detyrës së kryetarit të PD-së. Më 25 mars 2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë regjistroi ndryshimet statutorë të miratuara në dhjetor 2021 nga një kuvend kombëtar i PD-së i thirrur nga mbështetësit e zotit Berisha dhe më pas, më 22 mars, anëtarët e partisë e zgjodhën atë si kryetar partie. Z. Alibeaj apeloj vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe Gjykata e Apelit Tiranë më 3 mars 2023 e rrëzoi atë vendim dhe i ktheu përfaqësimin ligjor të partisë z. Alibeaj. Z. Berisha dhe Partia e tij Demokratike e Shqipërisë-Komisioni i Rithemelimit (PDKR) kanë njoftuar se do të apelojnë atë vendim.

### IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet vendore rregullohen kryesisht nga Kushtetuta (miratuar në 1998) dhe Kodi Zgjedhor (miratuar në 2008); ndryshuar për herë të fundit në 2020. Ligjet e tjera të aplikueshme përfshijnë Ligjin për Partitë Politike, Ligjin për Tubimet, Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Garantimin e Integritetit të Personave të Zgjedhur, të Emëruar ose që Ushtrajnë Funksione Publike (i ashtuquajtur Ligji për Dekriminalizimin). Aktet rregulluese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) plotësojnë

<sup>2</sup> Më 6 mars 2022, u mbajtën zgjedhjet e pjesshme në gjashtë bashki që kishin mbetur pa kryetar (Dibër, Durrës, Lushnjë, Rrogozhinë, Shkodër dhe Vorë); Partia Demokratike e Shqipërisë-Komisioni i Ri-themelimit e udhëhequr nga Sali Berisha, garoi me koalicionin Shtëpia e Lirisë, fitoi në Shkodër, ndërsa PS mbajti pesë postet e tjera të kryebashkiakut.

<sup>3</sup> Kushtetuta parashikon të drejta të plota politike, civile dhe sociale për personat që u përkasin pakicave kombëtare. Në Shqipëri janë nëntë minoritete kombëtare të njohura zyrtarisht- Minoritetet Arumune, Boshnjake, Bullgare, Egjiptiane, Greke, Maqedonase, Malazeze, Rome dhe Serbe. Të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 listojnë më pak se 1,5 përqind të popullsisë që i përkasin një pakice kombëtare. Megjithatë, 15.6 përqind e të anketuarve nuk e kanë deklaruar përkatësinë e tyre etnike.

<sup>4</sup> Aleanca për Ndryshim e udhëhequr nga PD fitoi 59 mandate; LSI fitoi 4 mandate; dhe Partia Social Demokratike (PSD) fitoi 3 vende. Pesëdhjetë nga deputetët e zgjedhur (35 përqind) janë femra.

<sup>5</sup> Trembëdhjetë nga 17 ministrat në qeverinë aktuale janë femra.

<sup>6</sup> Më 19 maj 2021, Departamenti i Shtetit i SHBA-së shpalli *persona non grata* z. Berisha, për shkak të dyshimit të përfshirjes së tij në korrupsion madhor, veçanërisht gjatë mandatit të tij si kryeministër. Në vitin 2022, edhe Mbretëria e Bashkuar e shpalli zotin Berisha *persona non grata*. Tom Doshi, kryetar i PSD-së, u shpall *persona non grata* nga Shtetet e Bashkuara në vitin 2018.

legjislacionin lidhur me zgjedhjet. Shqipëria është palë e traktateve kryesore ndërkombëtare që lidhen me zgjedhjet demokratike dhe të drejtat e njeriut dhe është anëtare e Komisionit të Këshillit të Europës për Demokracinë përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) dhe e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

Dispozitat e reja të paraqitura pas ndryshimeve të vitit 2020, që ndër të tjera kanë të bëjnë me administrimin zgjedhor, financimin e fushatës dhe masat mbrojtëse kundër abuzimit me burimet publike, do të zbatohen në zgjedhjet vendore për herë të parë. Ndërsa, një sërë rekomandimesh të mëparshme të ODIHR-it u adresuan, duke përfshirë ato për masat mbrojtëse kundër abuzimit me burimet publike dhe garancitë e forcuara për balancën gjinore në listat e kandidatëve, shumë prej tyre ende nuk janë zbatuar, përfshirë ato që lidhen me përbërjen e komisioneve zgjedhore të nivelit më të ulët, mekanizmi i tërheqjes së kandidatëve, e drejta e votës për personat me aftësi të kufizuar intelektuale ose psikosociale, përgjegjësia penale për shpifje, përdorimi i materialeve të fushatës të përgatitura nga partitë politike në lajme dhe të drejta të barabarta të vëzhguesve partiakë dhe qytetarë. Në shkurt 2022, Parlamenti ngriti një komision *ad hoc* për reformën zgjedhore për të ndjekur rekomandimet e paadresuara zgjedhore të ODIHR-it. Komisioni, mandati i të cilit u zgjat së fundmi deri në shtator 2023, ka pasur aktivitet të kufizuar, pa rezultate deri më tani.

Kryetarët e bashkive dhe këshilltarët bashkiakë zgjidhen drejtpërsëdrejti për një mandat katërvjeçar. Kryetarë të bashkive zgjidhen kandidatët që fitojnë numrin më të madh të votave të vlefshme, ndërsa këshilltarët zgjidhen sipas sistemit proporcional me listë të mbyllur.<sup>7</sup> Numri i këshilltarëve në çdo bashki varion nga 15 deri në 61. Kodi Zgjedhor është i paqartë nëse pragu një përqind i parashikuar për zgjedhjet parlamentare zbatohet edhe për zgjedhjet vendore<sup>8</sup>. ODIHR-i dhe Komisioni i Venecias kanë rekomanduar më parë që të qartësohet përcaktimi i pragut për zgjedhjet vendore dhe të bëhet një ndryshim përkatës në Kodin Zgjedhor përpara këtyre zgjedhjeve.<sup>9</sup>

## V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet vendore menaxhohen nga një administratë zgjedhore me tre nivele, e cila përbëhet nga KQZ-ja, 92 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe 5211 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi kryhet nga Grupet e Numërimit (GN) në 92 Vende të Numërimit të Votave (VNV).

Pas ndryshimeve të vitit 2020, KQZ përbëhet nga tre organe të veçanta drejtuese: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) dhe Nënkomisioneri, Komisioni Rregullator (Rregullatori) dhe Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve (KAS). Të gjithë anëtarët e KQZ-së zgjidhen nga parlamenti me shumicë prej tre të pestash.<sup>10</sup> Vetëm tre nga 12 anëtarët janë femra, duke përfshirë Nënkomisioneren.

<sup>7</sup> Nëse dy ose më shumë kandidatë për kryetar bashkie marrin numër të barabartë votash të vlefshme, KQZ-ja do të hedhë shortin për të përcaktuar fituesin.

<sup>8</sup> Neni 166, pika 3 e Kodit Zgjedhor parashikon se mandatet e këshilltarëve bashkiakë ndahen sipas të njëjtave procedura me ato të parashikuara për zgjedhjet parlamentare.

<sup>9</sup> Shih [Opinionin e Përbashkët 2020 të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias](#) mbi ndryshimet Kushtetuese të 30 korrikut dhe të Kodit Zgjedhor të 5 tetorit.

<sup>10</sup> Komisioneri zgjidhet për një mandat shtatëvjeçar, dhe Nënkomisioneri për një mandat katërvjeçar. Rregullatori përbëhet nga pesë anëtarë të zgjedhur për pesë vjet, ndërsa KAS funksionon me pesë anëtarë të zgjedhur për nëntë vjet. Komisioneri drejton administratën e KQZ-së dhe ushtron kompetenca ekzekutive, Nënkomisioneri mbikëqyr rekrutimin dhe trajnimin e anëtarëve të administratës zgjedhore dhe zbatimin e sistemit elektronik të identifikimit të zgjedhësve. Rregullatori nxjerr akte nënligjore dhe udhëzime të tjera normative, ndërsa KAS-i gjykon ankesat kundër Komisionerit, KZAZ-ve ose Rregullatorit.

Përgatitjet zgjedhore vijojnë, dhe deri më tani administrata zgjedhore ka respektuar shumicën e afateve ligjore.<sup>11</sup> Komisioneri, Rregullatori dhe KAS mbajnë seanca të rregullta, të transmetuara drejtpërdrejt në internet dhe të hapura për mediat dhe vëzhguesit. Në përgjithësi, vendimet publikohen pak më vonë në faqen e internetit të KQZ-së<sup>12</sup>. Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së të ODIHR-it vunë re transparencë dhe hapje të shtuar në vendimmarrjen e tij.

KZAZ-të u ngritën më 12 shkurt dhe janë përgjegjëse për zhvillimin e zgjedhjeve në zonat e tyre zgjedhore përkatëse.<sup>13</sup> Çdo KZAZ përbëhet nga shtatë anëtarë dhe një sekretar pa të drejtë vote, të emëruar nga shumica parlamentare dhe opozita.<sup>14</sup> Partitë politike mund të tërheqin ose zëvendësojnë anëtarët e komisioneve të tyre sipas gjykimit të tyre dhe pa justifikim<sup>15</sup>. Deri më 22 prill, 29 përqind e anëtarëve të KZAZ-së ishin femra, duke përfshirë 19 nga 92 kryetarët. KQZ-ja ka informuar MVZ-në e ODIHR-it se për shkak të numrit të lartë të zëvendësimeve të anëtarëve të KZAZ-së, planifikon të zhvillojë trajnime shtesë për anëtarët e rinj.<sup>16</sup> Seancat e KZAZ-ve janë publike dhe vendimet e tyre publikohen në ambientet e tyre ose vihen në dispozicion sipas kërkesës. KQV-të përbëhen në të njëjtën mënyrë si KZAZ-të dhe do të formoheshin më 24 prill. Ligji parashikon që qendrat e votimit të vendosen në ambiente të aksesueshme. Disa bashkëbisedues të MVZ-së të ODIHR shprehën shqetësime për qasjen në qendrat e votimit dhe pjesëmarrjen e zgjedhësve me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor.

KQZ-ja ka nisur një fushatë të gjerë dhe shumë të dukshme për edukimin e votuesve, përfshirë dhe në faqen e saj të internetit. KQZ-ja, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, ka përkthyer procedurat kryesore të votimit në tetë gjuhët e pakicave kombëtare, si dhe në gjuhën e shenjave. Megjithatë, disa bashkëbisedues të MVZ-së të ODIHR-it, vunë në dukje se materialet lehtësisht të kuptueshme për edukimin e zgjedhësve nuk janë të disponueshme. Postera dhe spote për identifikimin e votuesve dhe krimet zgjedhore janë gjithashtu të disponueshme në gjuhët e pakicave kombëtare.

KQZ-ja do të pilotojë një votim elektronik në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë, duke mbuluar 401 QV.<sup>17</sup> Votuesit do të votojnë duke përdorur makineri me ekran me prekje (pajisje elektronike me regjistrim të drejtpërdrejtë), me një printer gjurmësh auditimi letre, asnjë prej të cilëve nuk është e lidhur me internetin. Rezultatet paraprake do të publikohen menjëherë pas mbylljes, dhe do të bëhet një numërim manual paszgjedhor i të gjitha konfirmimeve, për të verifikuar saktësinë. Përgatitjet për pilotimin janë duke u zhvilluar dhe KQZ-ja ka nisur një fushatë për edukimin e votuesve dhe simulime publike në tre bashki.

<sup>11</sup> MVZ-ja e ODIHR-it vuri në dukje disa vonesa në publikimin e listave të zgjedhësve, ndarjen e kohës falas për subjektet zgjedhore dhe përcaktimin e renditjes së subjekteve në fletëvotim.

<sup>12</sup> MVZ-ja e ODIHR-it vuri në dukje disa raste kur vendimet e KQZ-së nuk u publikuan në faqen e internetit të KQZ-së ose nuk u diskutuan publikisht përpara miratimit të tyre.

<sup>13</sup> Bashkitë me mbi 80.000 zgjedhës të regjistruar ndahen nga KQZ-ja në më shumë se një Zonë Zgjedhore. Për këto zgjedhje, 50 nga 92 KZAZ-të janë në përputhje me bashkinë përkatëse dhe merren me regjistrimin e kandidatëve dhe akreditimin e vëzhguesve partiakë. Për 11 bashkitë e mbetura, regjistrimi i kandidatëve dhe akreditimi i vëzhguesve partiakë janë kryer nga KQZ-ja.

<sup>14</sup> Tre anëtarë të KZAZ-së emërohen nga shumica parlamentare dhe tre nga opozita parlamentare (dy nga partia kryesore opozitare/në pushtet dhe një nga partia e dytë e shumicës/opozitës parlamentare). Anëtari i shtatë propozohet nga PS në KZAZ-të me numër çift dhe nga PD në KZAZ-të me numër tek. Kryetari i KZAZ-së përfaqëson partinë që ka emëruar anëtarin e shtatë, ndërsa nënkryetari është i përkatësisë së kundërt. Sekretari propozohet nga subjekti politik që emëron zëvendëskryetarin.

<sup>15</sup> Seksioni II.3.1.f i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore](#) të Komisionit të Venecias 2002, thotë se "organet që emërojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të jenë të lira t'i shkarkojnë ata sipas dëshirës".

<sup>16</sup> Deri më 22 prill, rreth 26 përqind e të gjithë anëtarëve të KZAZ-ve ishin zëvendësuar, për shkak të tërheqjeve, mungesës së dokumentacionit ose dorëheqjes. Tre anëtarë u shkarkuan.

<sup>17</sup> Çdo qendër votimi në këto tre bashki do të pajiset me dy makineri. Në total, KQZ ka prokuruar 828 pajisje votimi elektronike. Fletët e votimit në letër do të jenë të disponueshme në qendrat e votimit si rezervë, në rast të mosfunksionimit të pajisjeve.



## VI. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Qytetarët e moshës 18 vjeç e lart në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë të votojnë, me përjashtim të atyre që janë gjetur të paafte me vendim gjykatë, gjë e cila bie ndesh me detyrimet ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar.<sup>18</sup> E drejta e votës pezullohet edhe për shtetasit që vuajnë dënimin me burg për kryerjen e disa krimeve të caktuara<sup>19</sup>.

Regjistrimi i zgjedhësve është pasiv dhe i decentralizuar. Votuesit mbi 100 vjeç hiqen automatikisht nga listat e zgjedhësve dhe duhet të konfirmojnë statusin e tyre në mënyrë që të përfshihen në regjistrin e zgjedhësve.<sup>20</sup> Listat e zgjedhësve nxirren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile dhe mbahen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) pranë Ministrisë së Brendshme (MB). Zyrat vendore të gjendjes civile, në koordinim me kryetarin e bashkisë përkatëse, përpiluan listat e zgjedhësve dhe publikuan ekstraktet mujore të listave të zgjedhësve që nga nëntori 2022. Zgjedhësit mund të verifikonin të dhënat e tyre duke përdorur një sërë opsionesh deri më 4 prill<sup>21</sup>. Pas kësaj, ndryshimet mund të kërkohej përmes gjykatës së rrethit, deri në 24 orë përpara ditës së zgjedhjeve.<sup>22</sup> Listat përfundimtare të zgjedhësve përmbajnë gjithsej 3,650,550 zgjedhës.<sup>23</sup>

Pas shpalljes së zgjedhjeve, MB-ja ka nxjerrë një udhëzim në të cilin është përshkruar metodologjia e përpilimit të listave zgjedhore. Në janar të vitit 2023, MB-ja ka ndryshuar këtë udhëzim, duke specifikuar kritere shtesë dhe ka caktuar votuesit në qendrat e votimit sipas kodit të ndërtesës dhe alfabetit sipas mbiemrit.<sup>24</sup> Në nëntor 2022, KQZ emëroi dy auditues për të mbikëqyrur hartimin e listave të zgjedhësve, të cilët kanë vërejtur në raportet e tyre periodike se ndryshimet e fundit të qendrave të votimit kanë prekur rreth 1,3 milionë zgjedhës.<sup>25</sup> Disa bashkëbisedues të MVZ-së të ODIHR-it besojnë se kjo mund të çorientojë votuesit në ditën e zgjedhjeve.

Identifikimi i zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve kryhet me pajisje elektronike të identifikimit offline që përmbajnë listat e zgjedhësve të të gjitha qendrave të votimit. Zgjedhësit duhet të kenë karta identiteti ose pasaporta biometrike për të verifikuar identitetin e tyre dhe gjurmët e gishtave të tyre skanohen në vend të një nënshkrimi për të konfirmuar se ata janë identifikuar.<sup>26</sup> Një konfirmim me të dhëna personale dhe një foto printohet dhe ruhet nga KQV-të për verifikimin paszgjedhor. Rekrutimi i operatorëve teknikë për identifikimin e votuesve po vijon dhe KQZ-ja ka informuar MVZ-në e ODIHR-it se numri

<sup>18</sup> Neni 29 i [Konventës së 2006 për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara](#) (KDPAK) kërkon që shtetet palë "t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato në baza të barabarta me të tjerët". Shih gjithashtu paragrafin 48 të [Komentit të Përgjithshëm Nr.1 të nenit 12 të KDPAK](#). Paragrafi 7.3 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së](#) të vitit 1990 parashikon që shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së do t'u garantojnë të drejtën e votës universale dhe të barabartë qytetarëve të rritur". Bashkëbiseduesit e MVZ-së të ODIHR-it vunë në dukje se në praktikë, shumë pak zgjedhës janë të privuar nga kjo e drejtë për shkak të paafësisë mendore, intelektuale apo psikosociale.

<sup>19</sup> Ligji për Dekriminalizimin pezullon të drejtat e votës për kryerjen e krimeve të renditura në më shumë se 80 nene të Kodit Penal (duke filluar nga veprat e lidhura me zgjedhjet deri te krimet e rënda).

<sup>20</sup> Rreth 3700 zgjedhës të moshës 100 vjeç e lart janë përfshirë në listat përfundimtare të zgjedhësve

<sup>21</sup> Zgjedhësit mund të kontrollojnë të dhënat e listës së tyre të zgjedhësve duke përdorur aplikacionin e KQZ-së ose portalet online në [e-albania](#). Ekstrakte të listës së zgjedhësve janë publikuar nga njësia zgjedhore.

<sup>22</sup> Listat e zgjedhësve iu shpërndanë KZAZ-ve deri më 9 prill dhe listat përfundimtare të zgjedhësve u publikuan menjëherë më pas.

<sup>23</sup> Lista përfundimtare e votuesve përfshin 1,843,170 zgjedhës meshkuj dhe 1,807,380 femra.

<sup>24</sup> Në përputhje me ndryshimin e këtij udhëzimi të janarit 2023, MB-ja i ndau qendrat e votimit me më shumë se 1000 zgjedhës në dy ose më shumë fraksione duke i grupuar votuesit me të njëjtin kod banese dhe sipas mbiemrave. Sipas bashkëbiseduesve të ODIHR-it, ky ndryshim është konsultuar paraprakisht me KQZ-në dhe partitë politike. Audituesit deri më tani kanë publikuar nëntë raporte.

<sup>25</sup> Audituesit deri më tani kanë publikuar nëntë raporte.

<sup>26</sup> KQZ ka vendosur kritere të reja për identifikimin e zgjedhësve, për të adresuar tentativat e mundshme për vjedhjen e identitetit. Zgjedhësit do të kenë mundësi deri në tre tentativa për t'u identifikuar me anë të gishtit të madh dhe tregues. Nëse kjo dështon, ata do të duhet të nënshkruajnë listën e zgjedhësve dhe printimin nga pajisja, në mënyrë që të lejohen të votojnë.

i kufizuar i aplikimeve për këto pozicione në disa zona mund të ndikojë në përgatitjet e ditës së zgjedhjeve.

## VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Çdo zgjedhës me të drejtë vote ka të drejtë të garojë për zgjedhjet vendore, përveç atyre që vuajnë dënimin me burgim ose janë dënuar për një kategori të caktuar krimesh ose janë në kërkim, si dhe ata që mbajnë pozicione publike të papajtueshme me statusin e kandidatit.<sup>27</sup>

Partitë dhe koalicionet politike duhet të regjistrohen në KQZ si subjekte zgjedhore përpara dorëzimit të listave të kandidatëve për këshillat bashkiakë dhe kryetarëve të bashkive.<sup>28</sup> Një kandidat mund të paraqitet vetëm në një listë dhe renditja në listën e kandidatëve nuk mund të ndryshohet pas regjistrimit. Subjektet zgjedhore duhet të dorëzojnë listat e kandidatëve në KZAZ-të përkatëse ose në KQZ, jo më vonë se data 25 mars. Që të regjistroheshin listat e kandidatëve për këshillat bashkiakë duhet të paraqitnin një numër të njëjtë femrash dhe meshkujsh kandidatë të alternuar në listë. Kandidatët e pavarur për kryetarët e bashkisë dhe këshillat bashkiakë mund të emëroheshin deri më 25 mars, nga grupe me jo më pak se nëntë zgjedhës banues në bashkinë përkatëse.

Partitë dhe koalicionet politike, të cilat nuk janë të përfaqësuara në parlament ose në këshillat bashkiakë përkatës, si edhe kandidatët e pavarur, duhet të dorëzonin firmat mbështetëse të jo më pak se 1 përqind të zgjedhësve të regjistruar në bashki.<sup>29</sup> Sipas ligjit, administrata zgjedhore verifikon 5 përqind të firmave të depozituara. Kandidaturat verifikohen në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe me Ligjin për Dekriminalizimin.<sup>30</sup>

Gjithsej 40 parti dhe koalicione me 144 kandidatë për kryetar bashkie dhe rreth 23,700 kandidatë për këshillat bashkiakë, janë duke garuar për 61 pozicione për kryetar bashkie dhe 1,603 pozicione për anëtarë këshilli, duke përfshirë dy kandidatë të pavarur për kryetar bashkie dhe dhjetë për këshillat bashkiakë.<sup>31</sup> Vetëm 15 nga 144 kandidatët për kryetar bashkie janë femra. Dyzet kandidatë janë ende nën shqyrtim nga Prokuroria e Përgjithshme dhe vendimi përfundimtar mbi pranueshmërinë e tyre është pezull.

<sup>27</sup> Ligji për Dekriminalizimin i referohet dëbimit nga një shtet anëtar i BE-së, Australisë, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara. Ligji, gjithashtu, referon qytetarët e dënuar për krime të caktuara, edhe në mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, si dhe ata për të cilët ka një urdhër për kërkim ndërkombëtar. Gjyqtarët, prokurorët, oficerët e ushtrisë, policisë dhe sigurimit kombëtar, personeli diplomatik, prefektët, anëtarët e komisioneve zgjedhore, Presidenti i Republikës dhe zyrtarët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuar me ligj, duhet të japin dorëheqjen që të kenë të drejtë të kandidojnë.

<sup>28</sup> Partitë duhet të dorëzojnë dokumentacionin për regjistrim deri më 6 mars dhe koalicionet deri më 15 mars.

<sup>29</sup> Partitë politike që nuk kanë përfaqësim në parlament ose në këshillat vendore duhet të dorëzojnë jo më pak se 50 por jo më shumë se 3000 nënshkrime mbështetëse, pavarësisht nga lloji i zgjedhjeve. Ndërsa, kandidatët e pavarur për zgjedhjet vendore duhet të dorëzojnë nënshkrimet e zgjedhësve të barabartë me 1 përqind të votuesve të regjistruar në bashkinë përkatëse, pavarësisht nga madhësia e saj. Kandidatit të pavarur Eduard Nallbani iu refuzua regjistrimi për shkak të nënshkrimeve të pamjaftueshme të mbështetësve dhe pragu për bashkinë e Tiranës është përcaktuar me 7,000 zgjedhës.

<sup>30</sup> KQZ-ja dhe 50 KZAZ-të verifikojnë që kandidatët kanë të drejtë të kandidojnë dhe KQZ-ja verifikon që kandidatët përmbushin kriteret ligjore për integritetin, pra, që nuk janë dënuar ose nuk janë nën hetim për vepra penale të caktuara. Nëse është i nevojshëm një hetim i mëtejshëm, ata i referojnë kandidatët në Prokurorinë e Përgjithshme.

<sup>31</sup> Mbështetur në të dhënat e KQZ-së, tre partive dhe shtatë grupeve të votuesve iu refuzua regjistrimi për shkak të dokumentacionit jo të plotë. Tre kandidatë për kryetar bashkie dhe 10 kandidatë për këshilltarë vendorë u tërhoqën pasi ishin regjistruar. KQZ-ja më 18 prill 2023 rivendosi kandidatin për kryetar bashkie të Nismës Thurje në Dropull (Qarku i Gjirokastrës), pas vendimit të Kolegjit Zgjedhor.

## VIII. FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata zgjedhore filloi zyrtarisht në datën 14 prill dhe përfundon një ditë përpara zgjedhjeve, mesnatën e ditës së premte, 12 maj. Nuk lejohet të bëhet fushatë një ditë para ditës së zgjedhjeve ose në ditën e zgjedhjeve.

Partitë politike të mëdha e kanë filluar zyrtarisht fushatën. Ato duken të jenë të orientuara më tepër ndaj profileve të kandidatëve sesa platformave specifike politike të tyre, ku zgjedhjet e këshillave kanë kaluar në plan të dytë krahasuar me zgjedhjen e kryetarëve të bashkisë. Ndërkohë që grupet kryesore të opozitës e nisën fushatën e tyre me takime publike, PS në pushtet ka deklaruar që ka synim të ketë një fushatë jo të bujshme.<sup>32</sup> Kështu, që fushata ka qenë relativisht modeste dhe me ton të moderuar deri më tani. MVZ-ve të ODIHR-it është në dijeni të dy rasteve të dhunës, ku në njërin prej tyre u rrezikua jeta e një anëtari partie.<sup>33</sup>

Përgjithësisht, fushata është e dukshme, veçanërisht në Tiranë, ku MVZ-ve të ODIHR-it ka vërejtur një prani të konsiderueshme të materialeve të fushatës në terren, përgjithësisht deri më tani ekskluzivisht nga PS. Disa garues iu shprehën MVZ-së të ODIHR-it që kishin planifikuar ta bënin fushatën në media sociale, me vizita derë më derë, takime të vogla me zgjedhës, dhe postera të vegjël.<sup>34</sup>

Fushata në objektet publike është e ndaluar.<sup>35</sup> Vendimi Nr. 9 i KQZ, i vitit 2020 miratuar me qëllim që të kufizonte mundësinë e përdorimit të burimeve të administratës, ndalon aktivitetet politike nga nënpunësit gjatë orarit të punës. KQZ-ja është e autorizuar të shqyrtojë me kujdes të gjitha veprimtaritë e institucioneve publike për të identifikuar abuzimin e burimeve publike dhe të ndalojë veprimtaritë që nuk janë në përputhje me ligjin. Për të monitoruar përputhshmërinë, KQZ në janar 2023 ka caktuar 119 monitorues dhe ka krijuar një mekanizëm raportimi javor.<sup>36</sup>

Duke filluar nga katër muaj përpara ditës së zgjedhjeve dhe deri në formimin e qeverisë së re, autoritetet nuk mund të propozojnë, të miratojnë, apo të nxjerrin vendime që parashikojnë rritje të përfitimeve financiare. Në lidhje me këtë, shumë bashkëbisedues të MVZ-në të ODIHR-it kanë ngritur shqetësime për vendimin e 31 marsit që parashikon një bonus prej 5,000 Lekësh (përafërsisht 44 Euro) për pensionistët, që do shpërndahet në prill, si dhe premtimet për rritjen e pagave të grupeve të ndryshëm të punonjësve në sektorin publik, të shprehura në disa raste gjatë prillit nga kryeministri. Meqënëse disa palë të interesuara shprehën shqetësimin për mosreagimin zyrtar të KQZ-së, Komisioneri u shpreh publikisht se sipas interpretimit të tij, dispozita përkatëse në Kodin Zgjedhor ishte e zbatueshme vetëm për zgjedhjet parlamentare.<sup>37</sup> Në 22 prill, në Kamëz (në qarkun e Tiranës), Z. Rama deklaroi, ndërkohë që i referohej në mënyrë përçmuese kandidatit të Komisionit të Rithemelimit të PD, se mbështetja e qeverisë së ardhshme ndaj bashkive do kushtëzohej nga rezultati i zgjedhjeve.<sup>38</sup>

<sup>32</sup> Koalicioni “Bashkë fitojmë” e nisi fushatën në stadiumin kombëtar të futbollit në Tiranë, me disa mijëra të pranishëm, duke prezantuar personalisht 61 kandidatë për kryetar bashkie, përfshirë tre kandidatë femra. PD e nisi fushatën e saj në një sallë sporti në Tiranë, në praninë e disa qindra mbështetësve.

<sup>33</sup> Më datë 11 prill, në Vaun e Dejës (Qarku i Shkodrës) u vendos një bombë në makinën e një drejtuesi vendor të PDKR-së, që shkaktoi dëme materiale. Më 19 prill, një drejtues vendor i PSD-së dhe një kandidat për këshilltar në Shëngjin (Qarku i Lezhës) u qëllua për vdekje në biznesin e tij.

<sup>34</sup> MVZ-ja e ODIHR-it po ndjek faqet e mediave sociale të garuesve kryesorë dhe të kryetarëve të partive kryesore, si dhe faqet zyrtare të bashkive të përzgjedhura. Përveç kësaj, MVZ-ja e ODIHR-it po kryen një analizë cilësore të gjuhës së urrejtjes, gjuhës fyese ose komenteve përçmuese, ose pohimeve dizinformuese në rrjetet sociale.

<sup>35</sup> Këto ndalime rregullohen nga Kodi Zgjedhor, Ligji për Rregullat e Etikës në Administratën Publike dhe Ligji për Shërbimin Civil.

<sup>36</sup> Ndërmjet 13 janarit dhe 23 prillit janë raportuar 3503 aktivitete publike nga 147 institucione publike. Komisioneri ndaloi 30 nga këto aktivitete për shkelje të afatit të raportimit dhe/ose pjesëmarrje të përfaqësuesve politikë.

<sup>37</sup> Komisioneri e bëri [deklaratën](#) gjatë një konference për shtyp më 30 mars.

<sup>38</sup> Zoti Rama në [fjalimin e tij](#) tha se “Kush do të fusi gomarin me vesh të gjata në Bashki, ta harrojë qeverinë. Ta harrojë mbështetjen nga qeveria.”



Më 24 mars, kandidati i Komisionit të Rithemelimit i kërkoi Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të fillojë hetimin penal ndaj Kryeministrit Rama dhe të tjerëve lidhur me shpërndarjen dhe përdorimin e aplikacionit “Aktivisti”, prezantuar në 2022 nga PS. Kërkesa e kandidatit sugjeron që aplikacioni përdoret brenda administratës publike të kontrolluar nga PS, për të kontrolluar veprimtarinë nëpër media sociale të punonjësve vartës në sektorin publik për të mbështetur aktivitetet e PS dhe zyrtarëve qeveritarë dhe liderave të partisë në rrjetet sociale.<sup>39</sup>

## IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Garuesit mund ta financojnë fushatën me fonde publike dhe private. Në 12 prill, KQZ ndau 345,341,079 Lekë (përafërsisht 3.07 milion Euro) të fondit vjetor publik, parashikuar nga Ligji për Partitë Politike, tek 11 partitë që garuan në zgjedhjet e fundit parlamentare.<sup>40</sup> Partitë politike që morën të paktën 1 përqind të votave në zgjedhjet e fundit vendore kualifikohen të marrin fonde publike shtesë, parashikuar në Kodin Zgjedhor. Parlamenti caktoi 100 milion Lek për fushatën e zgjedhjeve lokale. Në mbështetje të kësaj, KQZ vendosi në 22 prill, tetë ditë mbas fillimit të fushatës, të ndajë rreth 97 milion Lek tek 13 subjekte zgjedhore.<sup>41</sup> Kandidatët e pavarur nuk përfitojnë nga fondet publike. Fondet private mund të përbëhen nga burime vetjake të garuesit, dhurime nga qytetarët shqiptarë dhe personat juridikë, dhe kreditë bankare. Dhurimet, përfshirë dhe dhurimet në natyrë, janë të kufizuara deri në 1 milion Lek (përafërsisht 8,850 Euro).<sup>42</sup>

Shpenzimet totale të fushatës për një parti nuk duhet të tejkalojnë 300 përqind, dhe ato të kandidatit të pavarur 50 përqind, të masës më të lartë të fondit publik të shpërndarë për një parti, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve të fundit vendore. Meqënëse këto fonde u përcaktuan më 22 prill, kufiri i shpenzimeve u bë i njohur për garuesit mbasi fushata kishte filluar.

Çdo garues duhet të regjistrojë çdo dhurim që merr, si dhe të dhëna identifikimi të dhuruesve, në një regjistër të veçantë të miratuar nga KQZ. Garuesve nuk u kërkohet të nxjerrin publikisht, përpara ditës së zgjedhjeve, burimin dhe vlerën e fondeve të mbledhura por duhet të dorëzojnë raporte financiare brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar. Kodi Zgjedhor paraqet një listë sanksionesh për shkeljet financiare gjatë fushatës. 120 monitoruesit e fushatës të caktuar nga KQZ, gjithashtu vërejnë zbatimin e rregulloreve lidhur me financimin e fushatës.<sup>43</sup>

## X. MEDIA

Mjedisi mediatik është i shumëllojshëm, me një numër të shumtë operatorësh që veprojnë në një treg të kufizuar reklamash. Ndërkohë që përdorimi i mediave online rritet në mënyrë të vazhdueshme,

<sup>39</sup> PS ka refuzuar ankesat se aplikacioni është përdur për të kontrolluar punonjësit në sektorin publik.

<sup>40</sup> Nga këto PS ka marrë rreth 151.5 milionë lekë, PD 106.4 milionë, Partia e Lirisë 15.5 milionë, PSD 12.3 milionë, Partia Republikane (PR) 11.5 milionë lekë, Partia për Drejtësi, Integritet dhe Unitet (PDIU) 9.8. milionë, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ), Partia Agrare Ambientaliste (PAA), Partia e Aleancës Progresive (PAP) dhe Partia Lëvizja e Legalitetit (PLL) 8.0 milionë secila dhe Nisma Thurje (NTH) 6.3 milionë. 1 euro është afërsisht 113 lekë.

<sup>41</sup> Për shkak të pagesave të vonuara nga fushata 2021, asnjë fond nuk iu dha PSD.

<sup>42</sup> Personat juridikë që kanë përfituar fonde prokurimi publik mbi 10 milionë lekë (afërsisht 88 500 euro), ata që janë përfshirë në projekte të partneritetit publik ose kanë borxhe ndaj buxhetit të shtetit, si dhe ata që ushtrojnë veprimtari në lidhje me median; nuk lejohen të dhurojnë për fushatat elektorale. Të gjitha donacionet mbi 50,000 lekë (afërsisht 440 euro) duhet të bëhen përmes një llogarie bankare të caktuar.

<sup>43</sup> Në datën 20 prill, qeveria miratoi një vendim për “Marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve administrative gjatë procesit zgjedhor”, në të cilin ngriti një task forcë ad hoc për koordinimin e procesit të monitorimit, e përbërë prej 11 ministrave dhe zyrtarëve shtetërorë, me përfaqësues të katër institucioneve të tjera, përfshirë KQZ-në dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

televizioni (TV) mbetet burimi kryesor i informacionit politik.<sup>44</sup> Disa bashkëbisedues të MVZ-së të ODIHR-it ngritën shqetësime lidhur me përqëndrimin dhe kontrollin e mediave nga ndërthurja e interesave të biznesit me interesat politike, duke vënë në dukje se të dy faktorët krijojnë pengesa për pavarësinë editoriale dhe i bëjnë gazetarët të pambrojtur ndaj presionit dhe vetë-censurimit.<sup>45</sup> Sulmet mbi gazetarët, retorika diskretituese e politikanëve, dhe vështirësitë për marrjen e informacioneve publike u identifikuan si faktorë kryesorë që prekën profesionistët e mediave.<sup>46</sup>

Kushtetuta parashikon lirinë e shprehjes, lirinë e medias, të drejtën e informimit dhe ndalon censurën. Megjithatë, shpifja vazhdon të jetë vepër penale dhe dënohet me gjoba të rënda.<sup>47</sup>

Ligji mbi Median Audiovizive rregullon mediat audiovizive; në një zhvillim pozitiv, ndryshimet e propozuara të njohura si “paketa-antishpifje”, të cilat u kritikuan nga disa organizata për të drejtat e njeriut, u anuluan nga parlamenti në Nëntor 2022.<sup>48</sup>

Kodi Zgjedhor rregullon mbulimin e fushatës të transmetuar nga mediat, të cilat duhet të ofrojnë raportim të paanshëm dhe të balancuar. Kodi përmban gjithashtu dispozita që synojnë nxitjen e transparencës për reklamën zgjedhore dhe raportet e monitorimit të medias. Më 13 mars, KQZ-ja caktoi kohë transmetimi falas për fushatën në transmetuesin publik Radio Televizioni Shqiptar (RTSH).<sup>49</sup> Koha e transmetimit me pagesë është e kufizuar në 90 minuta për kanal privat për çdo parti parlamentare dhe 10 minuta për partitë joparlamentare dhe kandidatët e pavarur, për të gjithë periudhën e fushatës.<sup>50</sup> Lejohen përmbajtjet e prodhuara nga partia në programet e lajmeve, me kusht që të jetë etiketuar qartë si e tillë.

Rregullatori i medias, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), është përgjegjës për monitorimin e përmbushjes së kërkesave ligjore nga ana e transmetuesve për mbulimin e fushatës. Më 14 prill, AMA nisi monitorimin e rreth 34 transmetuesve. Raportet ditore të monitorimit të mediave të AMA-s janë të disponueshme në faqen e internetit të KQZ-së, ku përfshijnë dhe shkeljet e vërejtura.<sup>51</sup>

Më 14 prill, MVZ-ja e ODIHR-it filloi monitorimin sasior dhe cilësor të pesë stacioneve televizive.<sup>52</sup>

## XI. ANKIMI ADMINISTRATIV DHE GJYQËSOR

Si rregull i përgjithshëm, ankesat mund të parashtrihen nga garuesit, interesat ligjorë të të cilëve preken, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit.<sup>53</sup> Ndërkohë që zgjedhësit mund të ankohen vetëm në lidhje me

<sup>44</sup> Shihni Rezultatet e [Sondazhit të Opinioneve të Marketingut Strategjik IPSOS mbi Besimin në Media nga marsi 2021](#).

<sup>45</sup> Në mars 2023, Komisioni për Punët e Jashtme të Parlamentit Evropian (PE) inicioi një [mocion për rezolutën e PE](#) mbi Raportin e Komisionit 2022 për Shqipërinë, “duke i kërkuar qeverisë të sigurojë transparencën e pronësisë së medias, financimit dhe reklamimit publik”.

<sup>46</sup> Në një [deklaratë](#) të datës 23 shkurt 2021, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias ngriti shqetësime lidhur me frikësimin dhe sulmet ndaj gazetarëve.

<sup>47</sup> Kodi Penal parashikon gjoba deri në 3 milionë lekë (rreth 26 800 euro).

<sup>48</sup> Mediat e shkruara janë të vetërregulluara, ndërsa operatorët online mbeten të parregulluar.

<sup>49</sup> Pesëdhjetë minuta në TV publik dhe 30 minuta në radio iu ndanë PS-së dhe PD-së, ndërsa partitë e tjera parlamentare morën secila nga 25 minuta në TV dhe 15 minuta në radio, dhe partitë joparlamentare morën secila nga 10 minuta në TV dhe radio. Shih [Vendimin e KQZ-së nr. 352](#). Më 18 prill, RTSH zhvilloi shortin për të përcaktuar radhën e paraqitjes së partive.

<sup>50</sup> Kodi Zgjedhor kërkon që transmetuesit privatë të dorëzojnë listat e çmimeve në KQZ pesë ditë përpara fillimit të periudhës zyrtare të fushatës. Në faqen e KQZ-së janë [të disponueshme](#) listat e çmimeve të 16 mediave.

<sup>51</sup> Raportet përfshijnë sasinë e kohës së transmetimit të ndarë për garuesit në zgjedhje, renditjen e paraqitjes së tyre në lajme, raportin gjinor, etj. Toni i mbulimit nuk përfshihet në raporte. Në datën 22 prill, sipas raporteve të AMA të publikuara në faqen e KQZ-së, janë konstatuar disa shkelje, kryesisht në lidhje me transmetimin e reklamave politike në orare të ndaluara dhe mosdhënien e regjistromeve të përmbajtjes së transmetuar AMA-s, sipas ligjit.

<sup>52</sup> Transmetuesi publik *RTSH-1* dhe privat *Top Channel*, *TV Klan*, *Vizion Plus* dhe *A2 CNN*. Gjithashtu, kryhet monitorim cilësor i disa operatorëve online.

<sup>53</sup> Ankesat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve mund të parashtrihen brenda pesë ditëve.

përfshirjen e tyre në listën e zgjedhësve dhe vëzhguesit mund të ankimojnë vetëm refuzimin e akreditimit të tyre, kushdo mund të paraqesë raportime lidhur me shkeljet e pretenduara në KQZ, përfshirë elektronikisht në faqen e internetit të KQZ-së. Procedura e ankimit administrativ është e hollësishme dhe përmban garanci të procesit të rregullt ligjor. Ankimet që nuk plotësojnë kushtet formale mund të ridorëzohen me korrigjime brenda 24 orëve.

Vendimet e Komisionerit dhe të KZAZ-ve mund të ankimohen në KAS, i cili ka dy ditë nga data e dorëzimit për të marrë vendim. Vendimet e KQZ-së dhe mosveprimet e KQZ-së mund të ankimohen brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë (Kolegji Zgjedhor), vendimet e të cilit merren brenda dhjetë ditëve dhe janë të formës së prerë.<sup>54</sup>

Deri më 22 prill, në KAS janë paraqitur 23 ankesa, ku shumica ka të bëjë me regjistrimin e kandidatëve.<sup>55</sup> KAS ka shqyrtuar gjithashtu 20 kërkesa të Komisionerit për vendosjen e sanksioneve për shkeljen e masave të parashikuara kundër keqpërdorimit të burimeve publike dhe ka pranuar 10 prej tyre.<sup>56</sup> Kolegji Zgjedhor gjykoi 11 ankime brenda afatit dhe në seanca publike. KQZ-ja informoi MVZ-rë të ODIHR-it se deri më 18 prill, shumica e 340 raportimeve të depozituara përmes portalit të saj online, ishin dorëzuar nga organizatat e shoqërisë civile dhe pretendonin keqpërdorim të burimeve publike.

## XII. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgim jopartiak të brendshëm dhe ndërkombëtar të të gjitha fazave të procesit zgjedhor. Partitë dhe koalicionet parlamentare mund të emërojnë përfaqësues të përhershëm në KQZ, ndërsa subjektet e tjera zgjedhore kanë të drejtë të emërojnë përfaqësues vetëm për periudhën zgjedhore. Subjektet zgjedhore, pasi janë regjistruar, mund të caktojnë një vëzhgues në KZAZ-të dhe KQV-të përkatëse dhe në çdo tryezë numërimi të votave. Koalicionet mund të caktojnë deri në tre përfaqësues për komision ose tavolinë numërimi, pavarësisht nga numri i partive në koalicion. Afati i fundit i paraqitjes së ankesave për akreditim për vëzhguesit vendas jopartiakë është 15 ditë para ditës së zgjedhjeve, dhe 72 orë për vëzhguesit ndërkombëtarë. Që nga 22 prilli, KQZ ka regjistruar gjithsej 180 vëzhgues vendas nga 10 organizata të shoqërisë civile dhe 131 vëzhgues ndërkombëtarë.

## XIII. AKTIVITETET E MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

MVZ-ve të ODIHR-it filloi në Tiranë më 6 Prill. Kreu i Misionit është takuar me Presidentin e Republikës, Zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe anëtarë të tjerë të KQZ-së, përfaqësues të partive politike, të shoqërisë civile dhe komunitetit diplomatik. MVZ-ve i ODIHR-it ka krijuar kontakte të rregullta me administratën zgjedhore, institucionet qeveritare të përfshira në procesin zgjedhor, gjyqësorin, partitë politike, kandidatët, shoqërinë civile, median dhe komunitetin diplomatik.

*Versioni anglisht është i vetmi dokument zyrtar.  
Ky raport është i disponueshëm dhe në gjuhën shqipe.*

<sup>54</sup> Komisioneri, në datën 20 prill, me një shkresë drejtuar Kolegjit Zgjedhor kërkoi që ankimet e mbetura në lidhje me regjistrimin e kandidatëve, të shqyrtoheshin jo më vonë se 24 orë pas depozitimit të tyre, për të shmangur vonesat në procesin e prodhimit dhe shpërndarjes së fletëve të votimit.

<sup>55</sup> Njëzet e një ankesa ishin në lidhje me regjistrimin e kandidatëve. Disa prej tyre kishin të bënin me debatin për regjistrimin dhe përfaqësimin ligjor të PD-së; të tjerat kishin të bënin, ndër të tjera, me precedentë penalë të pretenduar të kandidatëve, mbledhjen e nënshkrimeve dhe kërkesat teknike për dorëzimin e dokumentacionit të regjistrimit. Dy ankesat e mbetura kishin të bënin me përmbajtjen e fletës së votimit.

<sup>56</sup> Pjesa më e madhe ishte lidhur me raportimin e aktiviteteve publike gjatë periudhës katërmujore përpara zgjedhjeve.